



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr.263/2017

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Fejzullah Rexhepi kryesues, Ymer Hoxha dhe Zyhdi Haziri anëtarë, me pjesëmarrjen e zyrtares së lart ligjore Antigona Murati, duke vendosur lidhur me ankesën e parashtruar nga subjekti politik, Lëvizja Vetëvendosje, paraqitur kundër koalicionit PDK-AAK për shkak të parregullsisë në ditën e votimit në komunën e Podujevës, në Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, në seancën e panelit të mbajtur me 13.06.2017, mori këtë:

V E N D I M

Refuzohet si e pabazuar ankesa Anr.263/2017 e datës 12.06.2017 parashtruar nga subjekti politik, Lëvizja Vetëvendosje

A r s y e t i m

Me datën 12.06.2017, PZAP-i ka pranuar një ankesë nga subjekti politik, Lëvizja Vetëvendosje në të cilën pretendohet se në qendrën e votimit me numër 1836/01R, tek shkolla “Jetullah Islami” në fshatin Dyz, komuna Podujevës, komisionerja e subjektit të tyre ka tentuar të paraqesë ankesë pas lejimit të një qytetareje të votojë pa pasur dokumentet e nevojshme identifikuese por është ndalur nga kryesuesi i VV, përfaqësuesi i subjektit PDK. Sipas parashtruesit të ankesës përfaqësuesi i PDK-së, me lejimin e votimit pa mjet identifikues të personit në fjalë, ka bërë shkelje të Rregullores 09/2013.

PZAP-i, pas shqyrtimit të shkresave e lëndës, në kuptim të nenin 117 par.3 të LZP-së, gjeti se:

Ankesa është e pabazuar:

Paneli vlerëson se parashtruesi i ankesës në mbështetje të pretendimeve në ankesë nuk ka ofruar ndonjë dëshmi apo provë materiale e cila do ti vërtetonte pretendimet ankimore edhe pse barra e

te provuarit bie mbi parashtruesin e ankesës, në kuptim të nenit 117 par.3 të LZP-së, për të provuar pretendimet ankimore.

Andaj, nisur nga arsyet e theksuara më lartë nën 117 dhe 118 par. 1 të LZP-së, paneli, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia

Anr. 263/2017, më datën 13.06.2017



Kryesuesi i Panelit
Fejzullah Rexhepi

Këshillë Juridike:

Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 par. 4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda njëzetekatër (24) orëve, nga momenti i marrjes-pranimi të këtij vendimi.